



REPUBLICA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO			
KOMUNA MITROVICA E VERIUT / OPŠTINA SEVERNA MITROVICA			
MITROVICA NORTH MUNICIPALITY			
Njesia Org. Org. Jedin. Org. Unit.	03	Nr. Prot. Prot. Nr.	03-030/01-0005051/24
Nr. i faqeve Nr. stranica No. pages	12	Data Datum Date	24, 04, 2024

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

Komuna e Mitrovicës së Veriut
Opština Severna Mitrovica
Municipality of Mitrovica North

Drejtoria për Buxhet, Financa dhe Zhvillim Ekonomik

PLANI I PUNËS 2024

Janar 2024

Përmbajtja

Hyrje.....	3
Objektivat e Sektorit për Buxhet dhe Financa.....	4
Aktivitetet e Sektorit për Buxhet dhe Financa në vitin 2024.....	5
Parashikimet e Sektorit për Tatim në Pronë në vitin 2024.....	12
Parashikimet e Sektorit për Zhvillim Ekonomik në vitin 2024.....	12

1. Hyrje

Plani i punës së Drejtorisë për Buxhet, Financa dhe Zhvillim Ekonomik është pregaditur duke u përshtatur me nevojat specifike dhe objektivat e komunës si dhe nga detyrat dhe obligimet që dalin nga natyra e punës së drejtorisë. Aktivitetet të cilat kryhen në kuadër të drejtorisë janë të rregulluara me ligje dhe rregullore financiare.

Aktivitetet e Drejtorisë për Buxhet, Financa dhe Zhvillim Ekonomik janë të lidhura ngushtë me të gjitha sektoret dhe drejtoritë tjera komunale duke pasur parasysh se në DBFZHE planifikohen dhe përgatiten për t'i realizuar të gjitha çështjet financiare.

Drejtoria për Buxhet dhe Financa në bashkëpunim me Zyrtarin Kryesor Financiar organizon të gjithë hapat në proces të planifikimit të Buxhetit Komunal, nga Qarkoret buxhetore në muajin Maj e deri më 30 shtator të cdo viti fiskal, kur është data e fundit për aprovimin dhe regjistrimin e buxhetit në BDMS dhe PIP.

Gjithashtu ZKF cilësohet si mbajtës i buxhetit dhe raportues i tij. Prandaj përmes sektorit për Buxhet dhe Financa, raportohet realizimi i buxhetit sipas planifikimit për vitin fiskal.

Përgatitja e lëndëve dhe procedimi i tyre për ekzekutim përgatitet nga sektori ynë poashtu edhe Raportimi i obligimeve përgatitet nga ky sektor dhe në bazë të tyre procedohen pagesat (gjithmonë duke respektuar kërkesat e zyrtarëve autorizues).

2. Objektivat e Sektorit për Buxhet dhe Financa

Bazuar në analizën e situatës aktuale, kemi përcaktuar objektivat specifike për DBFZHE, përkatësisht Sektorit për Buxhet dhe Financa. Këto objektiva mund të përfshijnë rritjen e të ardhurave komunale, zvogëlimin e shpenzimeve të panevojshme, përmirësimin e transparencës financiare, dhe ndërtimin e një mjedisi të favorshëm për zhvillimin ekonomik lokal.

Për vitin 2024 si objektiva kryesore kemi vendosur:

1. Ngritjen e transparencës dhe performancës;
2. Ngritjen e nivelit të kontrollit të brendshëm;
3. Rekrutimin e stafit të nevojshëm të Sektorit për Buxhet dhe Financa.

Objektivat e këtij plani janë të lidhura direkt me qëllimin e funksionimit të sektorit për Buxhet dhe Financa në kuadër të Drejtorisë për Buxhet, Financa dhe Zhvillim Ekonomik. Organizimi dhe delegimi i detyrave të detajizuara ka për qëllim të ngritë performancën e SBF dhe dhe arritjen e objektivave për secilin zyrtar në veçanti.

Realizimi i planit do të raportohet në baza tremujore dhe sipas arritjes së rezultateve do të azhurohet edhe ky plan. Në fund të vitit do të kemi mundësi të bëjmë vlerësimin e performancës dhe arritjen e objektivave, duke u bazuar në këtë plan.

Respektimi i ligjeve dhe akteve nën ligjore në fuqi do të jetë aktiviteti kryesor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa.

3. Aktivitetet e Sektorit për Buxhet dhe Financa në vitin 2024

Gjatë vitit ky plan do të rishikohet disa here sipas nevojës dhe do të plotësohet me ndryshimet e kërkuara. Plani do të raportohet ne periudha tremujore për realizimin e tij. Realizimi i këtij plani do të ndikoj në performancën e Drejtorisë për Buxhet dhe Financa. Në vazhdim do të prezentojmë të gjitha aktivitetet dhe rezultatet e pritura të Sektorit për Buxhet dhe Financa në detaje për të gjitha punët për të cilat SBF është përgjegjës për planifikimin, përgatitjen, realizimin dhe raportimin e tyre.

Muaji	Aktivitetet-Detyrat	Përshkrimi I punëve	Rezultatit I pritur	Afati kohor
Janar	Te Hyrat Vetanake	Barazimet me Drejtorinë Komunale Barazimet me Thesar/MFPT Raportimi i THV	Njoftimi mbi procesin e barazimit dhe realizimit të inkasimit të të hyrave vetanake.	10.01.2024
	Arka	Barazimi i Arkës (Dorëzimi i mjeteve në bankë dhe verifikimi i gjendjes në SIMFK) dhe identifikimi i të gjitha avanseve të hapura nga viti paraprak	Raport detaj i pagesave të realizuara në Arkën e Komunës dhe mbyllja e PettyCash në përputhje me instruksionet nga MFPT.	10.01.2024
	Takimi me zyrtarë	Takimi me zyrtarët e SBF për të identifikuar kërkesat, detyrat dhe obligimet e tyre për vitin 2024	Organizimi punëve për vitin 2024	10.01.2024
	Qasja në SIMFK	Përgatitja e kërkesave për qasje në SIMFK.	Njoftimi i organizatës buxhetore me të gjithë zyrtarët që do të kenë qasje në SIMFK.	15.01.2024
	Pasqyrat Vjetore Financiare 2023	Asistimi te Zyrtari Kryesor Financiar për përgatitjen e Pasqyrave Vjetore Financiare për vitin 2023.	Vërtetësia e plotë e të dhënave të ofruara nga zyrtarët komunal për PVF.	31.01.2024
	Plani I Rrjedhes se parase	Përgatitja e CashFlow duke u bazuar në ndarjet buxhetore të ligjit të Buxhetit 2024 dhe prioritetet e Drejtorive.	Alokimet e mjeteve në baza periodike në përputhje me prioritetet e përcaktuara.	31.01.2024
	Raporti Financiar Janar-Dhjetor 2023	Përgatitja e Raportit Financiar për realizimin e Buxhetit Komunal gjatë vitit 2023	Analiza financiare e ekzekutimit të buxhetit në krahasim me planifikimin e tij	31.01.2024
	Obligimet e papaguara	Asistimi në përgatitjen e obligimeve të papaguara deri fund të muajit Janar 2024	Raportimi i obligimeve (faturave) të papaguara të Komunës së Mitrovicës Veriore	31.01.2024

Shkurt	Te Hyrat Vetanake	Alokimet e THV nga muaji Janar Barazimet me Arkën e Komunës Barazimet me Drejtoritë Komunale Barazimet me Thesar/MFPT Raportimi i THV	Njoftimi mbi procesin e barazimit dhe realizimit të Planit Vjetor 2024 të inkasimit të të hyrave vetanake.	05.02.2024
	Raporti I Punës Janar 2024	Mbledhja e raporteve të punës nga zyrtarët e SBF dhe përgatitja e Raportit Mujor për Drejtoreshen e DBFZHE	Krahasimi i punëve në raport me planin dhe raportimi i tyre	05.02.2024
	Obligimet e papaguara	Asistimi në përgatitjen e obligimeve të papaguara deri në fund të muajit Janar 2024	Raportimi i obligimeve (faturave) të papaguara të Komunës së Mitrovicës Veriore	10.02.2024
Mars	Raporti I Punës Shkurt 2024	Mbledhja e raporteve të punës nga zyrtarët e SBF dhe përgatitja e Raportit Mujor për Drejtoreshen e DBF	Krahasimi i punëve në raport me planin dhe raportimi i tyre	05.03.2024
	Te Hyrat Vetanake	Alokimet e THV nga muaji Shkurt Barazimet me Arkën e Komunës Barazimet me Drejtoritë Komunale Barazimet me Thesar/MFPT Raportimi i THV	Njoftimi mbi procesin e barazimit dhe realizimit të Planit Vjetor 2024 të inkasimit të të hyrave vetanake.	15.03.2024
	Obligimet e papaguara	Asistimi në përgatitjen e obligimeve të papaguara deri në fund të muajit Shkurt .	Raportimi i obligimeve (faturave) të papaguara të Komunës së Mitrovicës Veriore	15.03.2024
	Të hyrat Vetanake 22	Përgatitja e raporti për mbetjen e të hyrave vetanake të pa shpenzuara gjatë vitit 2023 dhe procedimi i tij.	Alokimi i të hyrave vetanake të pa shpenzuara gjatë vitit 2023.	31.03.2024
Prill	Raporti I Punës Mars 2024	Mbledhja e raporteve të punës nga zyrtarët e SBF dhe përgatitja e Raportit Mujor për Drejtoreshen e DBF	Krahasimi i punëve në raport me planin dhe raportimi i tyre	05.04.2024
	Raporti Financiar Janar-Mars 2024	Përgatitja e Raportit Financiar për realizimin e Buxhetit Komunal gjatë periudhës Janar — Mars 2024.	Analiza financiare e ekzekutimit të buxhetit në krahasim me planifikimin e tij	20.04.2024
	Të Hyrat Vetanake	Alokimet e THV nga muaji Mars Barazimet me Arkën e Komunës Barazimet me Drejtoritë Komunale Barazimet me Thesar/MFPT Raportimi i THV	Njoftimi mbi procesin e barazimit dhe realizimit të Planit Vjetor 2024 të inkasimit të të hyrave vetanake.	15.04.2024

	Trajnimi dhe çertifikimi I zyrtarëve të rinj	Kerkesa për trajnim dhe çertifikim për SIMFK të zyrtarëve të rinj në Thesar	Trajnimi dhe çertifikimi I zyrtarëve në Thesar për SIMFK	Prill
	Obligimet e papaguara	Asistimi në përgatitjen e obligimeve të papaguara deri fund të muajit Prill 2024	Raportimi i obligimeve (faturave) të papaguara të Komunës së Mitrovicës	15.04.2024
Maj	Raporti I Punës Prill 2024	Mbledhja e raporteve të punës nga zyrtarët e SBF dhe përgatitja e Raportit Mujor për Drejtoreshën e DBF	Krahasimi i punëve në raport me planin dhe raportimi i tyre	05.05.2024
	Qarkorja Buxhetore-2025/01	Asistimi në përgatitjen e kufijve fillestar të Buxhetit 2025—2027	Njoftimi i Drejtorive Komunale me kufijt fillestar buxhetore 2025-2027	20.05.2024
	Te Hyrat Vetanake	Alokimet e THV nga muaji Prill Barazimet me Arkën e Komunës Barazimet me Drejtoritë Komunale Barazimet me Thesar/MFPT Raportimi i THV	Njoftimi mbi procesin e barazimit dhe realizimit të Planit Vjetor 2024 të inkasimit të të hyrave vetanake.	10.05.2024
	Obligimet e papaguara	Asistimi në përgatitjen e obligimeve të papaguara deri fund të muajit Prill 2024	Raportimi i obligimeve (faturave) të papaguara të Komunës së Mitrovicës Veriore	15.05.2024
	Raporti I Punës Maj 2024	Mbledhja e raporteve të punës nga zyrtarët e SBF dhe përgatitja e Raportit Mujor për Drejtoreshën e DBF	Krahasimi i punëve në raport me planin dhe raportimi i tyre	05.06.2024
Qershor	Te Hyrat Vetanake	Alokimet e THV nga muaji Maj Barazimet me Arkën e Komunës Barazimet me Drejtoritë Komunale Barazimet me Thesar/MFPT Raportimi i THV	Njoftimi mbi procesin e barazimit dhe realizimit të Planit Vjetor 2024 të inkasimit të të hyrave vetanake.	10.06.2024
	Obligimet e papaguara	Asistimi në përgatitjen e obligimeve të papaguara deri fund të muajit Maj 2024	Raportimi i obligimeve (faturave) të papaguara të Komunës së Mitrovicës Veriore	30.06.2024
	Korniza Afatmesme Buxhetore	Asistimi në përgatitjen e KAB Komunal dhe përcaktimi i nevojave të shpenzimeve sipas kategorive ekonomike për vitin 2025 dhe vlerësimet për 2026 dhe 2027.	Identifikimi i kufijve buxhetore për kategoritë ekonomike buxhetore 2025-2027	30.06.2023 Dorëzimi në MFPT
Korrik	Rishikimi I Planit Vjetor të Punës	Organizimi i takimit për të rishikuar PVP dhe për të analizuar implementimin e tij dhe ndryshimet e nevojshme.	Analize - Realizimi i Planit Vjetor të Punës.	05.07.2024

	Raporti i punës Qershor 2024	Mbledhja e raporteve të punës nga zyrtarët e SBF dhe përgatitja e Raportit Mujor për Drejtoreshen e DBF	Krahasimi i punëve në raport me planin dhe raportimi i tyre	7.05.2024
	Obligimet e papaguara	Asistimi në përgatitjen e obligimeve të papaguara deri fund të muajit Qershor 2024	Raportimi i obligimeve (faturave) të papaguara të Komunës së Mitrovicës	15.07.2024
	Te Hyrat Vetanake	Alokimet e THV nga muaji Qershor Barazimet me Arkën e Komunës Barazimet me Drejtoritë Komunale Barazimet me Thesar/M FPT Raportimi i THV	Njoftimi mbi procesin e barazimit dhe realizimit të Planit Vjetor 2024 të inkasimit të të hyrave vetanake.	10.07.2024
	Qarkorja Buxhetore 2025/02	Asistimi në përgatitjen e kufijve fillestar të Buxhetit 2024 sipas QB 2024/02	Njoftimi i Drejtorive Komunale me kufijt final sipas kategorive ekonomike buxhetore 2025- 2027	20.07.2024
	Dëgjimet Buxhetore me qytetarë	Organizimi i dëgjimeve buxhetore me qytetarë në kaudër të procesit të planifikimit të Buxhetit 2025- 2007, në KK dhe në terren.	Përmbledhja e kërkesave të qytetarëve dhe njoftimi i Kryetarit të Komunës përmes raportit me shkrim	25.07.2024
	Raporti Financiar Janar-Qershor 2024	Përgatitja e Raportit të Brendshëm Financiar për realizimin e Buxhetit Komunal gjatë periudhës Janar — Qershor 2024	Analiza financiare e ekzekutimit të buxhetit në krahasim me planifikimin e tij	30.07.2024
Gusht	Raporti mbi Dëgjimet Buxhetore me qytetarë	Filtrimi i kërkesave të qytetarëve gjatë dëgjimeve buxhetore, eliminimi i kërkesave të përsëritura dhe Përgatitja e Raportit mbi dëgjimet buxhetore me qytetarë	Përmbledhja e kërkesave të qytetarëve dhe njoftimi i Kryetarit të Komunës përmes raportit me shkrim	10.08.2024
	Raporti i punës Korrik 2024	Mbledhja e raporteve të punës nga zyrtarët e SBF dhe përgatitja e Raportit Mujor për Drejtoreshen e DBF	Krahasimi i punëve në raport me planin dhe raportimi i tyre	05.08.2024
	Obligimet e Papaguara	Asistimi në përgatitjen e obligimeve të papaguara deri fund të muajit Korrik 2024	Raportimi i obligimeve (faturave) të papaguara të Komunës së Mitrovicës Veriore	15.08.2024

	Dëgjimet Buxhetore me Drejtor të Drejtorive	Organizimi i Dëgjimeve Buxhetore me Drejtorët Komunal për Buxhetin 2024-2026, duke i njoftuar me kufijt final Buxhetore për vitet pasuese.		Gusht
	Projekt - Buxheti 2025-2027	Perfundimi I Projekt-Buxhetit 2025-2027 dhe dorëzimi I tij tek ZKA dhe KK	Aprovimi i Projekt-Buxhetit 2025-2027 nga ZKA	Gusht
	Të Hyrat Vetanake	Alokimet e THV nga muaji Korrik Barazimet me Arkën e Komunës Barazimet me Drejtoritë Komunale Barazimet me Thesar/MFPT Raportimi i THV	Njoftimi mbi procesin e barazimit dhe realizimit të Planit Vjetor 2024 të inkasimit të të hyrave vetanake.	20.08.2024
Shtator	Raporti i punës Gusht 2024	Mbledhja e raporteve të punës nga zyrtarët e SBF dhe përgatitja e Raportit Mujor për Drejtorin e DBF	Krahasimi i punëve në raport me planin dhe raportimi i tyre	05.09.2024
	Obligimet e Papaguara	Asistimi në përgatitjen e obligimeve të papaguara deri fund të muajit Gusht 2024	Raportimi i obligimeve (faturave) të papaguara të Komunës së Mitrovicës Veriore	15.09.2024
	Buxheti 2025—2027	Regjistimi i të dhënave në sistemin BDMS dhe PIP Dorëzimi i Buxhetit në Departamentin e Buxhetit në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve	Finalizimi i Buxhetit 2025-2027	30.09.2024
	Të Hyrat Vetanake	Alokimet e THV nga muaji Gusht Barazimet me Arkën e Komunës Barazimet me Drejtoritë Komunale Barazimet me Thesar/MFPT Raportimi i THV	Njoftimi mbi procesin e barazimit dhe realizimit të Planit Vjetor 2024 të inkasimit të të hyrave vetanake.	Shtator
Tetor	Raporti i punës Shtator 2024	Mbledhja e raporteve të punës nga zyrtarët e SBF dhe përgatitja e Raportit Mujor për Drejtorin e DBF	Analiza financiare e pranimit dhe ekzekutimit të lëndëve në SBF.	05.10.2024
	Obligimet e Papaguara	Asistimi në përgatitjen e obligimeve të papaguara deri fund të muajit Gusht 2023	Asistimi në përgatitjen e obligimeve të papaguara deri fund të muajit Shtator 2024	15.10.2024

	Raporti Financiar Janar — Shtator 2024	Përgatitja e Raportit Financiar për realizimin e Buxhetit Komunal gjatë periudhës Janar — Shtator 2024 dhe dorezimi I tij tek ZKA dhe KK	Analiza financiare e ekzekutimit të buxhetit në krahasim me planifikimin e tij	20.10.2024
	Pagesat e ekzekutuara nga Thesari/MF përmes PP dhe Nenit 39.2	Raporti detaj i pagesave nga Thesari/MF dhe analiza financiare mbi ekzekutimin e buxhetit përmes pagesave direkte për TM1-TM3.	Forcimi i Kontrollit të Brendshëm Financiar Ngritja e nivelit të komunikimit me Avokatin e Komunës	Tetor
	Të Hyrat Vetanake	Alokimet e THV nga muaji Shtator Barazimet me Arkën e Komunës Barazimet me Drejtoritë Komunale Barazimet me Thesar/MFPT Raportimi i THV	Njoftimi mbi procesin e barazimit dhe realizimit të Planit Vjetor 2024 të inkasimit të të hyrave vetanake.	Tetor
	Mbyllja e Afatit të Zotimeve	Njoftimi paraprak i Drejtorive Komunale për mbylljen e afatit të zotimeve për kategorinë ekonomike të Investimeve Kapitale.	Efikasiteti i zotimit të mjeteve	31.10.2024
Nentor	Raporti i punës Tetor 2024	Mbledhja e raporteve të punës nga zyrtarët e SBF dhe përgatitja e Raportit Mujor për Drejtoreshën e DBF	Krahasimi i punëve në raport me planin dhe raportimi i tyre	05.11.2024
	Obligimet e Papaguara	Asistimi në përgatitjen e obligimeve të papaguara deri fund të muajit Tetor 2024	Raportimi i obligimeve (faturave) të papaguara të Komunës së Mitrovicës Veriore	15.11.2024
	Të Hyrat Vetanake	Alokimet e THV nga muaji Tetor Barazimet me Arkën e Komunës Barazimet me Drejtoritë Komunale Barazimet me Thesar/MFPT Raportimi i THV	Njoftimi mbi procesin e barazimit dhe realizimit të Planit Vjetor 2024 të inkasimit të të hyrave vetanake.	Nentor
	Mbyllja e Afatit të Zotimeve	Njoftimi paraprak i Drejtorive Komunale për mbylljen e afatit të zotimeve për kategorinë ekonomike të Mallrave dhe Shërbimeve.	Efikasiteti i zotimit të mjeteve	26.11.2024
Dhjetor	Raporti i punës Nëntor 2024	Mbledhja e raporteve të punës nga zyrtarët e SBF dhe përgatitja e Raportit Mujor për Drejtoreshën e DBF	Krahasimi i punëve në raport me planin dhe raportimi i tyre	05.12.2024

Obligimet e Papaguara	Asistimi në përgatitjen e obligimeve të papaguara deri fund të muajit Nentor 2024	Raportimi i obligimeve (faturave) të papaguara të Komunës së Mitrovicës Veriore	15.12.2024
Mbyllja e afatit të Zotimeve	Njoftimi paraprak i Drejtorive Komunale për mbylljen e afatit të zotimeve për kategorinë ekonomike të Subvencione dhe Transfere	Efikasiteti i zotimit të mjeteve	10.12.2024
Mbyllja e afatit të Zotimeve	Njoftimi paraprak i Drejtorive Komunale për mbylljen e afatit të zotimeve për avancet e udhëtimeve zyrtare dhe parave të imta.	Efikasiteti i zotimit të mjeteve	24.12.2024
Mbyllja e vitit fiskal	Njoftimi paraprak i Drejtorive Komunale për mbylljen e afatit të ekzekutimit të pagesave për vitin 2023	Efikasiteti i zotimit të mjeteve	24.12.2024
Takimi përmbyllës	Organizimi i takimit përmbyllës të stafit SBF	Analiza e realizimit të Planit Vjetor 2024	24.12.2024
Barazimi i Arkës	Barazimi final i Arkës Komunale	Raportimi mbi barazimet 2024. Raporti përgatitet nga komisioni që formohet nga ZKA.	31.12.2024
Plani Vjetor i Punës 2025	Mbledhja e PVP të zyrtarëve SBF dhe përgatitja e Planit Vjetor 2025	Përgatitja për vitin fiskal 2025	31.12.2024

4. Parashikimet e Sektorit për Tatim në Pronë në vitin 2024

Gjatë vitit 2024 pritet të hapet Zyra e Tatimit në Pronë, pasi që nuk ka pasur më herët në Komunën e Mitrovicës Veriore.

Fillimisht do të rekrutohet stafi dhe me kompletim të stafit do të fillojmë procesin e regjistrimit gjithmonë duke bashkëpunuar me Departamentin e Tatimit në Pronë dhe Departamentin e Vlerësimit të Pronave. Gjatë vitit 2024 do të bëhet ky regjistrimi i objekteve ekzistuese dhe atyre të reja në mënyrë që në vitin 2025 të jenë të dhënat në databazat përkatëse dhe të lëshohen faturat tatimore. Gjithashtu së bashku me stafin e ri do të përpilojmë planin e aktiviteteve për vitin fiskal 2024.

5. Parashikimet e Sektorit për Zhvillim Ekonomik në vitin 2024

Gjatë vitit 2024 do të rekrutohet stafi në Sektorin për Zhvillim Ekonomik, ku në kuadër të këtij sektori është Zyra për Biznes- ARBK. Në bashkëpunim me ARBK do të punohet në lehtësimin e procedurave të hapjes së bizneseve të reja dhe duke bashkëpunuar me ministritë përkatëse do të përpiqemi që të ofrojmë grante për bizneset e Komunës së Mitrovicës Veriore.



Drejtoresha për Buxhet, Financa dhe Zhvillim Ekonomik

Mevlyde PECI SHALA